



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.140/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e medias vendore “VIM INFO DOO”, paraqitur kundër Vendimin të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.protokolli 01/2812/2025 nga Zyra për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike, me të cilin u refuzua kërkesa për akreditim të vëzhguesve për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** e bazuar ankesa e medias vendore “VIM INFO DOO” e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.protokolli 01/2812-2025, i datës 09.10.2025.

II. **ANULOHET** Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.protokolli 01/2812-2025, i datës 09.10.2025, dhe lënda i kthehet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në rishqyrtim dhe në rivendosje.

A r s y e t i m

Me datë 10.10.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga media vendore “VIM INFO DOO”, e cila pretendon se me datë 09.10.2025, KQZ ka marrë vendim për refuzimin e akreditimit të 18 vëzhguesve të medias vendore “VIM INFO DOO” me arsyetimin se ka dyshime mbi vërtetësinë e medias se paraqitur, përfshirë origjinën dhe legjitimitetin e dokumentacioneve të dorëzuar. Ky vendim është i pabazuar në fakte dhe në ligj, sepse sipas parashtruesit të ankesës media vendore “VIM INFO DOO” ka plotësuar të gjitha kriteret për akreditim dhe vëzhgim të Zgjedhjeve Vendore 2025. Tutje shtojnë se ky vendim është thjeshtë shprehje e vullnetit politik të anëtarëve të KQZ të cilët janë caktuar nga subjektet politike dhe në këtë mënyrë ata kanë shkelur shkelur nenin 54 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe nenin 4, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore nr.08/2024. Bazuar në këtë parashtruesi i ankesës kërkon që PZAP të anulojë vendimin e KQZ-së nr. 01/2812-2025, të datës 09.10.2025 dhe të urdhërojë KQZ-në që të akreditojë 18 vëzhguesit e medias vendore “VIM INFO DOO” për Zgjedhjet Lokale të 12 tetorit 2025.

Si dëshmi parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur provat: Kopja e vendimit të KQZ-së, me nr.protokolli 01/2812-2025 datë 09.10.2025 si dhe Çertifikatën e regjistrimit ne ARBK të medias vendore “VIM INFO DOO”.

PZAP ka dërguar kërkesë për përgjigje në KQZ, mirëpo KQZ në raport me këtë rast ka konstatuar se media “VIM INFO DOO” nuk është akredituar, pa dhënë ndonjë arsye për këtë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë të KQZ, gjeti se:

- Ankesa është e bazuar

Paneli vlerëson se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se media vendore “VIM INFO DOO”, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, ka përfunduar aplikimin për akreditim të tetëmbëdhjetë (18) vëzhguesve si media vendore në Zyrën për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ.

KQZ-ja, në mbledhjen e mbajtur me datë 09.10.2025, ka marr vendim me numër 01/2812-2025, me te cilin ka refuzuar akreditimin me arsyetim se media vendore “VIM INFO DOO” nuk ka marrë votat e nevojshme për akreditimin e vëzhguesve për zgjedhjet lokale.

Ankesë kundër këtij vendimi ka paraqitur media vendore “VIM INFO DOO” e cila kundërshton mos akreditimin si vëzhgues për zgjedhjet lokale, me vlerësim se vet KQZ ka pranuar se i ka plotësuar kushtet për akreditim, ashtu siç është përcaktuar me nenit 47,48 dhe 49 të Ligjit Për Zgjedhjet.

Paneli, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, qëndrimin dhe përfundimin e KQZ-së, të përshkruar si në vendimin e tij të datës 09.10.2025 me numër protokoli 01/2812-2025, vlerëson se përfundimin e KQZ në këtë vendim nuk mund ta pranoj si të drejtë dhe të ligjshëm, nga arsyet në vijim.

Paneli vlerëson se vendimi i atakuar është i paqartë dhe në kundërshtim me shkresat e lëndës, kjo pasi që KQZ në njërën anë në arsyetim të vendimit konstaton se media “VIM INFO DOO” ka plotësuar kushtet për akreditim, ndërsa në dispozitiv refuzon akreditimin pa dhënë arsye konkrete për refuzim. Media në fjalë ka kërkuar të jetë vëzhgues në zgjedhjet lokale, andaj KQZ ka për obligim që aplikimin ta vlerësoj në pikëpamje të kritereve të përcaktuara për akreditim dhe dispozitave ligjore që e rregullojnë këtë çështje. Nga arsyetimi i vendimit nuk rezulton se ka ndonjë arsye për faktet vendimtare të çështjes, që kanë të bëjnë me të drejtën për të qenë vëzhgues të zgjedhjeve lokale. Andaj akti administrativ është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e neneve 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga të cilat rrjedh detyrimi i organit që në aktin administrativ të paraqes arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare të çështjes.

KQZ nuk ka dhënë arsye për refuzim të akreditimit dhe njëherit as në përgjigje në ankesën e palës ankuese nuk ka dhënë arsye për të qartësuar arsyen e refuzimit. Pala ankuese ka të drejtë që nga organi kompetent të marrë përgjigje të arsyetuar për rastin e tij, përkatësisht për refuzimin e

akreditimit, e cila e drejtë buron nga neni 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndërlidhur me nenin 6 të KEDNJ.

Paneli vlerëson se vendimi i KQZ është në kundërshtim me nenin 54 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili e parasheh te drejtën për akreditim të mediumeve, kjo pasi që refuzimi i kërkesës për akreditim është bërë pa arsye dhe vlerësim në pikëpamje të kriterëve dhe kushteve që duhet plotësuar që një media ta fitoj të drejtën për akreditim për pjesëmarrje si vëzhgues në zgjedhjet lokale.

Nga këto arsye, Paneli ka kthyer rastin në rivendosje në KQZ, në mënyrë që KQZ ta vlerësoj kërkesën për akreditim sipas kriterëve të përcaktuara dhe dispozitat ligjore që rregullojnë këtë çështje.

Paneli vlerëson se nga dispozitat e lartcekura, rezulton se vendimi i atakuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për çka vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, dhe urdhëroi KQZ-në që të rishqyrtoj vendimin sipas nenit 118 par.5 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe dispozitave nga neni 13 par. 11 të Rregullores nr.01-2025 Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZL.Anr.140/2025, datë 11.10.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuti



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.